

V E N D I M
Nr.731, datë 11.11.1998

PËR KRIJIMIN E DREJTORISË SË KONTROLLIT TË BRENDSHËM ADMINISTRATIV

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin Popullor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për forcimin e kontrollit të brendshëm në administratën shtetërore, për rritjen e efikasitetit dhe të përgjegjësisë në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, krijohet Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm Administrativ. Kjo drejtori ushtron kontroll, në emër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, në të gjitha organet e administratës shtetërore, qendrore, përfshirë këtu edhe prefekturat, përveç organeve për të cilat kontrolli i brendshëm administrativ rregullohet me akte ligjore të veçanta.

2. Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm Administrativ është pjesë e strukturës organizative të Këshillit të Ministrave dhe përbëhet nga një drejtor e 7 inspektorë të cilët emërohen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ është në varësi të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

3. Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm Administrativ ka si objekt kryesor ushtrimin e kontrollit:

a) për zbatimin e ligjshmërisë në përgjithësi dhe në veçanti për zbatimin e akteve të nxjerra nga Këshilli i Ministrave dhe nga Kryetari i Këshillit të Ministrave;

b) për ndjekjen dhe për zbatimin e detyrave të tjera të ngarkuara nga Këshilli i Ministrave;

c) për kontrollin e bazueshmërisë ligjore të akteve të nxjerra nga organet e administratës shtetërore dhe harmonizimin e tyre me programin dhe objektivat e qeverisë. Veprimet dhe aktet nënligjore të ministrave mund të kontrollohen vetëm me urdhër të posaçëm të Kryetarit të Këshillit të Ministrave;

ç) për konstatimin e zvarritjeve, mungesën e koordinimit dhe konstatimin e konflikteve të interesave ndërmjet organeve të administratës shtetërore;

d) për konstatimin e shkeljeve ligjore dhe administrative në zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave dhe të detyrave të tjera të ngarkuara nga ai.

4. Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm Administrativ ushtron kontroll:

a) në bazë të një plani ose grafiku të hartuar nga kjo drejtori dhe të miratuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave;

b) me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave;

c) kur ka të dhëna për shkelje dhe të meta në veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore ose kur vetë kjo drejtori vëren të tilla.

5. Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm Administrativ çmon, sipas rrethanave, nëse është e

nevojshme të njoftohet paraprakisht organi që do të vihet nën kontroll për ushtrimin e këtij kontrolli dhe për objektin e tij.

Përpara fillimit të kontrollit, titullari i organit nën kontroll paraqet inspektorët të stafi të tij, si dhe u bën të njohur objektin e kontrollit.

Organi nën kontroll është i detyruar të verë në dispozicion të inspektorëve të gjitha dokumentet që kërkojnë ata, si dhe të japë sqarime e shpjegime, për çështje që lidhen me objektin e kontrollit apo me zbatimin e akteve ligjore, nënligjore dhe të detyrave të ngarkuara nga Këshilli i Ministrave dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave. Në rastet kur ka pengesë ligjore për njohjen e dokumenteve që përbëjnë sekret shtetëror, këqyrja e tyre nga inspektorët, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, bëhet me autorizim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, ose, në bazë të kërkesës së tij, me autorizim të organit kompetent, sipas ligjit.

Gjatë kontrollit, sipas rrethanave dhe objektit të tij, përveç inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ, mund të aktivizohen dhe specialistë të tjerë. Aktivizimi i tyre me propozimin e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ, bëhet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

6. Gjatë kontrollit mbahet aktkontrolli, i cili nënshkruhet nga inspektorët e, sipas rastit, edhe nga punonjësit dhe titullari i organit nën kontroll. Në rast se këta të fundit nuk janë dakort me përmbajtjen e aktit të kontrollit, kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime, që pasqyrohen në përmbajtjen e aktkontrollit. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktkontrollit.

Në përfundim të kontrollit, inspektorët hartojnë një raport përmbledhës për ecurinë e kontrollit, gjendjen dhe masat që propozohen për shmangien e shkeljeve e të mangësive, si dhe punonjësit e drejtuesit përgjegjës për to. Ky raport nënshkruhet nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ.

7. Kopje të aktkontrollit dhe të raportit përmbledhës, të hartuara sipas pikës 6 të këtij vendimi i jepen organit që kontrollohet, si dhe organit më të lartë epror të organit nën kontroll.

Pas çdo kontrolli i dërgohet Kryetarit të Këshillit të Ministrave një njoftim i shkurtër për rezultatet e kontrollit.

Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ i paraqet Kryetarit të Këshillit të Ministrave një relacion me shkrim për rezultatet e kontrollit dhe për masat që propozohen të merren, në rastet kur kontrolli është ushtruar:

- me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave;
- kur gjatë ushtrimit të tij janë vënë re dhe janë provuar shkelje të rënda ligjore, mangësi dhe probleme të tjera serioze, administrative.

Në raste të veçanta, për shkelje të rënda ose probleme me një rëndësi të veçantë, mund t'i propozohet Kryetarit të Këshillit të Ministrave, që materialet e kontrollit të analizohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

8. Në rastet kur kontrolli vëren se vendime, urdhra, udhëzime, rregullore, si dhe çdo akt tjetër i organeve të administratës shtetërore, nuk përputhen me dispozitat ligjore, me aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave, si dhe me parimet e një administrate të një shteti të së drejtës, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ i kërkon organit përkatës shfuqizimin e tyre. Për aktet e ministrave, kërkesa për shfuqizimin e tyre, i propozohet Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur ministri kundërshton shfuqizimin e aktit, çështja shqyrtohet nga Këshilli i Ministrave.

Gjithashtu, në rastet kur Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ vëren se marrëdhënie të caktuara nuk janë rregulluar me akte ligjore e nënligjore, si dhe aktet nënligjore nuk sjellin pasoja juridike, të kërkuara sipas qëllimit të nxjerrjes së tyre, si pasojë e mangësive, pasaktësive, mungesës së harmonizimit, mospërputhjes apo boshllëkut të rezultuar në dispozitat ligjore e nënligjore, i paraqet një raport shpjegues Kryetarit të Këshillit të Ministrave, së bashku me sugjerimet për ndryshimet apo aktet ligjore e nënligjore përkatëse, që duhen nxjerrë apo propozuar nga Këshilli i Ministrave.

9. Në përfundim të kontrollit Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ ka të drejtë:

- a) të pezullojë veprimet që kanë shkaktuar shkeljen;
- b) të caktojë detyra për përmirësimin e gjendjes;
- c) t'i kërkojë Kontrollit të Lartë të Shtetit të ndërmarrë një kontroll, duke i vënë në dispozicion aktin e kontrollit dhe raportin përmbledhës;
- ç) të propozojë masa disiplinore, deri në largimin nga detyra, të personave përgjegjës për shkeljet ligjore apo të metat e vëna re;
- d) në përputhje me ligjin të bëjë kallëzim për ndjekje penale.

Në të gjitha rastet, personat përgjegjës, ndaj të cilëve propozohet të merren masa disiplinore, duhet të dëgjoen paraprakisht dhe shpjegimet e dhëna prej tyre duhen shënuar në procesverbal.

Marrja e masave ndaj veprimeve dhe akteve të ministrave bëhen vetëm me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Marrja e masave të propozuara sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të kësaj pike, bëhet pas miratimit nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

10. Për të bërë të njohur legjislacionin, sidomos atë për administratën, si dhe aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm Administrativ, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të organizojë seminare ose takime pune me punonjës të institucioneve qendrore dhe të prefekturave, ku të trajtohen tema për aktet më të rëndësishme ligjore e nënligjore, duke shfrytëzuar edhe rezultatet e vëna re gjatë kontrolleve të ushtruara, nëse çmohet se problemet e trajtuara kanë rëndësi jo vetëm për organin e kontrolluar, por për të gjithë administratën shtetërore.

11. Fondi i pagave dhe numri i punonjësve të përballohen nga fondi i miratuar për aparatin e Këshillit të Ministrave, në buxhetin e shtetit të vitit 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko